

Liberalizimi i vizave:
Rriten gjasat,
por s'ka garanci



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

VETERANËT E UÇK-SË PROTESTOJNË SËRISH PARA KUVENDIT TË KOSOVËS

VETERANËT E UÇK-së KËRKOJNË QË TË PËRFSHIHEN NË RITJEN E PAGËS MINIMALE



Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë hyrë të enjten në oborrin e Kuvendit të Kosovës. Ata kanë protestuar në shenjë pakënaqësie ndaj miratimit në parim të Projektligjit për pagën minimale në Kuvend, në të cilin nuk është përfshirë edhe pensioni i tyre. Pas kësaj situatë kryeministri Albin Kurti ka anuluar pjesëmarrjen e tij në Forumin

e Prespës për Dialog për, siç ka thënë ai, për t'u takuar të premten me përfaqësuesit e OVLUK-së. Pavarësisht prej propozimit të Kurtit për takim të premten, ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVLUK-së, Faton Klinaku, ka thënë se protestuesit do të qëndrojnë para Kuvendit derisa të anulohet seanca e së enjtes

AKTUALE



IKSHPK-ja BËN THIRRJE PËR
TESTIM, BARTJE TË MASKAVE DHE
VAKSINIM KUNDËR COVIDIT

RAMA AKUZON QEVERINË KURTI
PËR DËSHTIMIN E 'SUNNY HILL'-it

SZUNYOG: SHOQËRIA CIVILE DHE
ORGANIZATAT MEDIATIKE, NJË NGA
PARTNERËT KRYESORË TË BE-së

EKONOMI



AKB-ja DHE ODA E ZEJTARËVE
TË PRIZRENIT NËNSHKRUAJNË
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

KULTURË



HAPET EDICIONI I DYTË I "BIENALES
NDËRKOMBËTARE TË VIZATIMIT 2022"

SPORT

MARMARINOS PUBLIKON LISTËN E
GJERË TË BASKETBOLLISTËVE

Raportime të
rrejtshme për
bomba në disa
shkolla të Kosovës



SUPREMJA VENDOS NË FAVOR TË
ZRRE-së, MBESIN NË FUQI FATURAT
E SHITJES

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja do ta ndihmojë Ukrainën me armatim me rreth një miliard dollarë

WASHINGTON, 16 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë njoftuar raunde shtesë armësh për Ukrainën me vlerë rreth 1 miliard dollarë, ndërsa Ukraina po u bën presion vendeve perëndimore për të ofruar më shumë ndihmë ushtarake përballë ofensivës së Rusisë në rajonin lindor të Donbasit. Presidenti i ShBA-së, Joe Biden, tha se e ka informuar presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy për ndihmën, duke përfshirë artileri shtesë dhe armë të mbrojtjes bregdetare si dhe municione për artileri dhe sisteme të avancuara raketore. "Ne, gjithashtu, mbetemi të përkushtuar për ta mbështetur popullin ukrainas, jetët e njerëzve të cilët janë shkatërruar nga kjo luftë", tha Bideni në një telefonatë

që pati më 15 qershor me presidentin ukrainas. Ai njoftoi edhe për një ndihmë humanitare prej 225 milionë dollarësh për njerëzit në Ukrainë. Paratë do të përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të sigurt, pajisje mjekësore, ushqim, strehim dhe para për familjet për të blerë artikuj esenciale. Paketat e pajisjeve ushtarake përfshijnë sistemin e shumëfishtë të raketahedhësve (MLRS), tashmë të dërguara në Ukrainë dhe raunde artilerie për obus, si dhe pjesë këmbimi në paketën e parë, sipas lajmeve të mëhershme që citojnë burimet e tyre. Një paketë e dytë pritet të përfshijë sisteme raketash kundër anijeve të bazuara në tokë, radio të sigurta, vizion nate

dhe stërvitje. Paketa e parë do ta përfshijë transferimin e artikujve tepriçë të mbrojtjes nga stoqet e ShBA-së, ndërsa paketa e dytë do të financohet nga Iniciativa e Ndihmës për Sigurinë e Ukrainës (USAID), një program i veçantë i autorizuar nga kongresi. Detajet do të tregohen nga sekretari i mbrojtjes i ShBA-së, Lloyd Austin, i cili është në Bruksel në një takim prej pothuajse pesëdhjetë vendesh, për të diskutuar për mbështetjen për Ukrainën. Në fillim të takimit Austin tha se Perëndimi duhet t'i shtojë dërgesat e armëve dhe "ta shtyjë veten edhe më shumë për të siguruar që Ukraina mund ta mbrojë veten, qytetarët dhe territorin e saj".



Turqia dërgon në paraburgim 16 gazetarë nën akuzat për "terrorizëm"



ANKARA, 16 QERSHOR - Gjashtëmbëdhjetë gazetarë turq të asociuar me mediet pro kurde u dërguan në paraburgim të enjten, në pritje të gjyqit, pasi akuzohen se i përkasin një "organizate terroriste". Gazetarët kanë punuar për medie të lidhura me Partinë Demokratike të Popullit (HDP), pro kurde, e cila rrezikon të ndalohet në Turqi për lidhje të dyshuara me militantët e jashtëligjshëm që nxisin prej dekadash një kryengritje kundër shtetit turk. Të 16 gazetarët u arrestuan, së bashku me katër gazetarë të tjerë, më 8 qershor në Diyarbakir të Turqisë juglindore, të akuzuar se u përkasin shërbimeve të shtypit të Partisë së jashtëligjshme të Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), e

klasifikuar si një grup "terrorist" nga Ankaraja, BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara. HDP-ja mohon lidhjet formale me PKK-në. Të enjten të 16 gazetarët u akuzuan se i përkasin një organizate terroriste", sipas dokumentit të arrestimit. Një avokat mbrojtës konfirmoi se ata ishin burgosur në pritje të gjyqimit. Ndër të arrestuarit është edhe Serdar Altan, bashkëkryetar i një shoqate gazetarësh. Katër të tjerët u lanë të lirë nën mbikëqyrje gjyqësore. Një përfaqësues nga dega turke e "Reporterëve pa Kufij" (RSF), Erol Onderoglu, denoncoi arrestimet si një përpjekje për ta dobësuar "klasën politike kurde... dhe për t'i privuar ata nga të drejtat për t'u dëgjuar" përpara zgjedhjeve presidenciale të Turqisë vitin e

ardhshëm. Turqia ka deklaruar se po planifikon të nisë një ofensivë në veri të Sirisë kundër militantëve kurde. Një numër i madh anëtarësh të HDP-së janë arrestuar pas një përpjekje të dështuar për grusht shtet kundër presidentit Rexhep Tajip Erdogan në vitin 2016. Aleatët perëndimorë të Turqisë janë alarmuar nga arrestimet, duke paralajmëruar se këto veprime kërcënojnë të minojnë më tej lidhjet diplomatike me qeverinë e Erdoganit. Turqia renditet e 149-ta nga 180 vende në indeksin e lirisë së shtypit sipas Reporterëve pa Kufij për vitin 2022 dhe kritikohet rregullisht për përndjekjen ndaj medieve që janë kritike të qeverisë.

Koreja Veriore përballet me shpërthim të ri të një sëmundjeje infektuese

PHENIAN, 16 QERSHOR - Koreja Veriore ka raportuar të enjten për shpërthimin e një epidemie të përditshme të zorrëve në një rajon bujqësor. Ky lajm rëndon edhe më shumë këtë shtet të izoluar teksa përballet me mungesa të ushqimit dhe me një valë të infektimeve me koronavirus. Lideri verikorean, Kim Jong Un, ka dërguar ilaçe në qytetin perëndimor Haeju të mërkurës, për t'u ndihmuar pacientëve që po përballet me "epidemi akute enterike", ka thënë agjencia shtetërore e lajmeve KCNA, pa dhënë detaje për numrin e të prekurve

dhe pa identifikuar sëmundjen. Termi enterik i referohet traktit gastrointestinal. "Kim ka theksuar nevojën e ndaljes së epidemisë sa më shpejt që është e mundur, duke marrë masa të karantinës për rastet e dyshuara", ka njoftuar KCNA. Një zyrtar i Ministrisë për Bashkim në Korenë e Jugut, i cili merret me çështjet mes dy Koreve, ka thënë se qeveria është duke vëzhguar shpërthimin që dyshohet se është kolerë apo tifo, sëmundje që shkaktohen si pasojë e ujit apo ushqimit të kontaminuar, apo kontaktit me feces të

personit të infektuar. Raportimi për këtë shpërthim vjen teksa verikoreanët po përballet me shpërthimin e parë të infektimeve me koronavirus. Koreja Veriore ka shpallur gjendje të jashtëzakonshme muajin e kaluar teksa autoritetet po përballet me mungesë të vaksinave dhe ilaçeve të tjera. Agjencia për spiunim e Koresë Jugore u ka thënë ligjvënësve se sëmundjet që barten përmes ujit, siç është tifoja, janë përhapur në Korenë Veriore edhe para se të shpërthente koronavirusi.



Liberalizimi i vizave: Rriten gjasat, por s'ka garanci

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Disa burime diplomatike të Bashkimit Evropian thonë se "Franca ka dhënë sinjale", se pas zgjedhjeve parlamentare në këtë vend, që do të mbahen më 19 qershor, "mund të mos e kundërshtojë më vendimin për liberalizimin e vizave për Kosovën".

Marrë parasysh se ky vend ka qenë kundërshtar i madh në BE i liberalizimit të vizave për Kosovën, sinjalet prej tij shihen si shenja optimiste se heqja e vizave për kosovarët do të ndodhë "shpejt". "Në nivelin e grupeve punuese dhe në nivele teknike në Këshillin e BE-së ne nuk kemi parë ndonjë lëvizje akoma në drejtim të vendimit për liberalizimin e vizave. Por, kemi parë, kohën e fundit, rritjen e gatishmërisë për këtë në nivel politik. Ka angazhim në nivel shumë të lartë politik dhe

kjo jep shpresë", thotë një diplomat i BE-së për "Radion Evropa e Lirë". "Kur të ketë pajtueshmëri dhe gatishmëri në nivelin më të lartë politik, atëherë puna në nivel teknik dhe procedural mund të ndodhë shumë shpejt", shton ai.

Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk gëzon liberalizim të vizave me BE-në.

Qeveria e Kosovës thotë se ka plotësuar çdo kriter nga gjithsej 95 sa i ka vendosur BE-ja në udhërrëfyesin për liberalizim. Megjithatë, procesi është penguar vazhdimisht nga disa shtete anëtare të BE-së, sidomos Franca, e cila ka shprehur rezerva për lëvizjen e lirë të kosovarëve.

Sipas burimeve diplomatike, Franca ka kërkuar më shumë garanci se, në rast të liberalizimit të

vizave për qytetarët e Kosovës, nuk do të ketë keqpërdorime dhe nuk do të ketë ardhje të azilkërkuesve të rejshëm në vendet e BE-së siç ka ndodhur me Shqipërinë dhe Gjeorgjinë.

Burimet diplomatike në Bruksel thonë se Kosova është angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me autoritetet e Francës për t'i adresuar shqetësimet e këtij shteti dhe se kjo mund të ketë pasur, po ashtu, ndikim pozitiv.

Një prej elementeve të rëndësishme, thonë burimet në BE, është edhe mbështetja publike që liberalizimit të vizave për Kosovën i ka dhënë kancelari gjerman Olaf Scholz gjatë vizitës së tij në Kosovë javën e kaluar.

Kjo çështje mund të përmendet edhe në samitin e BE-së që zhvillohet punimet më 23 dhe 24 qershor në Bruksel, edhe pse vendimi nuk

merret në këtë nivel të lartë, por nga Këshilli i BE-së.

Rikujtimin se liberalizimi i vizave për Kosovën është vonuar dhe se duhet të ndodhë pa vonesa e ka bërë të martën edhe Parlamenti Evropian përmes raportit për Kosovën, i cili është miratuar në Komisionin e Politikës së Jashtme të BE-së.

Në këtë raport është kërkuar nga vendet anëtare në Këshill që "me urgjencë" të ecin drejt miratimit të regjimit pa viza për qytetarët e Kosovës dhe është thënë se vonesat e reja në këtë drejtim do ta dëmtojnë besueshmërinë e BE-së dhe reputacionin e saj si partner i besueshëm.

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka qenë më e drejtpërdrejtë në kritika, duke bërë me gisht kah Franca dhe Holanda.

"Për fat të keq, Bashkimi Evropian ka dështuar t'i pëmbushë premtimet e veta për ta mundësuar lëvizjen pa viza për qytetarët e Kosovës. Unë vërtet shpresoj se ky do të jetë raporti i fundit i cili përmend këtë dështim. Sa i përket Këshillit - dhe në këtë drejtim dua t'u drejtohem direkt Francës dhe Holandës - koha për miratimin e vendimit është tash", ka thënë von Cramon.

Edhe pse pranojnë se "po krijohet një moment i duhur politik për liberalizimin e vizave për Kosovën", burimet në BE tërheqin vërejtjen se "nuk mund të thuhet në këtë moment se kur do të mund të merrej vendimi".

Në kohën kur kanë mbetur vetëm dy javë deri te përfundimi i kryesimit të Francës me BE-në, gjasat janë që ky vendim të hyjë në procedurë gjatë presidencës së Çekisë e cila nis nga 1 korriku.



Szunyog: Shoqëria civile dhe organizatat mediatike, një nga partnerët kryesorë të BE-së

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka nisur të enjten në Prishtinë një ngjarje dyditore që do të mbështesë më shumë se 20 organizata të shoqërisë civile (OShC) dhe mediatike për ta kontaktuar publikun dhe për ta rritur ndërgjegjësimin për kontributin e tyre për krijimin e një shoqërie më të drejtë, më demokratike dhe shoqërinë gjithëpërfshirëse në Kosovë.

Veprimtaria "BE-ja për shoqërinë civile dhe mediet në Kosovë - angazhimi i

qytetarëve", i mbajtur në sheshin "Zahir Pajaziti", ofron hapësirë për shoqërinë civile që t'i promovojë rezultatet më të rëndësishme të punës së tyre dhe ta inkurajojë publikun që të angazhohet në jetën politike dhe shoqërore përmes aktivizimit qytetar dhe vullnetarizmit. "Shoqëria civile dhe organizatat mediatike janë një nga partnerët kryesorë të BE-së në avokimin për reforma dhe promovimin e perspektivës së BE-së për Kosovën", ka thënë ambasadori i BE-së në Kosovë,

Tomas Szunyog.

Ai ka theksuar se Kosova gëzon një peizazh pluralist mediatik dhe një mjedis të favorshëm për zhvillimin e organizatave transparente dhe të përgjegjshme të shoqërisë civile. "BE-ja mbetet e përkushtuar që të angazhohet me aktorët e shoqërisë civile në nxitjen e progresit social, promovimin e të drejtave themelore dhe mbikëqyrjen e punës së qeverisë për të mirën e të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë", ka thënë Szunyog.





Veteranët e UÇK-së protestojnë sërish para Kuvendit të Kosovës

Veteranët e UÇK-së kërkojnë që të përfshihen në rritjen e pagës minimale

Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë hyrë të enjten në oborrin e Kuvendit të Kosovës. Ata kanë protestuar në shenjë pakënaqësie ndaj miratimit në parim të Projektligjit për pagën minimale në Kuvend, në të cilin nuk është përfshirë edhe pensioni i tyre. Pas kësaj situatë kryeministri Albin Kurti ka anuluar pjesëmarrjen e tij në Forumin e Prespës për Dialog për, siç ka thënë ai, për t'u takuar të premten me përfaqësuesit e OVLUÇK-së. Pavarësisht prej propozimit të Kurtit për takim të premten, ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka thënë se protestuesit do të qëndrojnë para Kuvendit derisa të anulohet seanca e së enjtes

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 16 qershor - Veteranët e UÇK-së kanë protestuar të enjten para Kuvendit të Kosovës në shenjë pakënaqësie të miratimit në parim të Projektligjit për pagën minimale, në të cilin nuk është përfshirë edhe pensioni i tyre. Derisa po zhvillohej seanca e Kuvendit të Kosovës, protestuesit kanë hyrë në oborrin e Kuvendit, pas shtyrjeve me forcat e Policisë së Kosovës, derisa në hyrje të këtij institucioni kanë qenë të pozicionuara njësitet speciale. "Këta deputetë që shkelin ligje, që shkelin Kushtetutë, nuk e kanë vendin këtu", ka thënë ushtruesi i

detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL të UÇK-së), Faton Klinaku, para ndërtesës së Kuvendit, duke bërë thirrje për tërheqje të Projektligjit. "Për shkak të këtij turpi të deputetëve, që nuk dëgjuan thirrjet tona, që të mos e miratojnë turpin e qeverisë, u detyruam të thërrasim protestë", ka thënë ai. Klinaku është zotuar për dërgim të projektligjit - nëse hyn në fuqi - edhe në instanca më të larta. "Ne jemi gati që nëse ligji hyn në fuqi, ju garantoj se ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, dhe 100 për qind jemi të sigurt që Gjykata Kushtetuese do ta konstatojë se këta shkelin ligje", është shprehur

Klinaku.

Ai ka paralajmëruar edhe protesta të tjera. "Lirisht mund t'ju them se secilin herë që këta (deputetë) do të kenë seanca, ne do të jemi këtu". Protestuesit janë dëgjuar duke bërë thirrje "Duam të drejtat tona" dhe "Duam një përgjigje". Ndonëse në seancën e së enjtes ishin planifikuar për diskutim pika të tjera, mes të tjerash edhe pika për tërheqjen e mjeteve nga Fondi Pensional, deputetët e opozitës kanë nisur takimin duke diskutuar për veteranët. Rashit Qalaj, deputet nga Partia Demokratike e Kosovës, ka thënë se nuk duhet të ketë mbledhje normale të Kuvendit derisa të zgjidhet çështja e përfitimeve të

veteranëve. "Sot do të duhej të ndiheshim të gjithë të turpëruar, sidomos ata që ishin kundër përfshirjes së veteranëve në marrjen e përfitimeve në lartësinë e pagës minimale. A thua i paskemi harruar të gjithë ata që i lanë gjymtyrët që ne sot të jemi këtu?", ka pyetur Qalaj. Arben Gashi nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka thënë se qeveria ka dështuar të ketë dialog frytdhënës me veteranët. "Një pjesë vitale e rëndësishme dhe kontributdhënëse për lirinë e vendit është në protestë jashtë Kuvendit sot për gabime të qeverisë. Është e padinjitetshme që veteranët e luftës të trajtohen në këtë mënyrë", ka thënë ai. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka kërkuar ndërprerjen e seancës dhe nisjen e dialogut me veteranët. Deputetët e opozitës kanë bllokuar dy herë foltoren e Kuvendit, duke pamundësuar vazhdimin e seancës. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, u ka thënë protestuesve se partia prej nga vjen ai nuk do ta lejojë vazhdimin

e seancës pa arritur zgjidhje për veteranët, dhe ka kërkuar që të përcaktohet pensioni i tyre në linjë me pagën minimale. Ai ka kërkuar që qeveria, Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe veteranët të mbajnë një takim të përbashkët për të diskutuar për këtë çështje.

**Kurti u kërkon
takim përfaqësuesve të
veteranëve**

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka propozuar që ta anulohë pjesëmarrjen e tij në Forumin e Prespës për Dialog që zhvillon punimet në Ohër të Maqedonisë së Veriut, ashtu që të takohet të premten me përfaqësuesit e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Ai e ka bërë këtë deklaratë në seancën e Kuvendit teksa jashtë ndërtesës kanë qenë duke protestuar veteranët në shenjë pakënaqësie ndaj miratimit në parim të Projektligjit për pagën minimale në Kuvend më 14 qershor. Projektligji nuk e parasheh lidhjen e pagës minimale me pensionin e

Konfliktet e Kurtit me arsimtarët, me mjekët, me veteranët e me rininë prishtinase janë pjesë e projektit “Republika e tretë”



Shkruan: **Milazim KRASNIQI**

Veprimet konfliktuale të Albin Kurtit po duken si veprime të palogjikshme, në shikim të parë. Por, ato janë të strukturuar brenda strategjisë së tij për themelimin e “Republikës së tretë.” Kurti e ka ëndërr të jetë

themelues republike, disi si Rugova e Thaçi, bile si De Goli. Vetëm ashtu mund të përjetojë iluzionin që t’i duket vetja i madh në histori. Prandaj po tenton të eliminojë kundërshtarët e Republikës së tretë nga skena: arsimtarët, veteranët, mjekët dhe rininë prishtinase. (Opozitën faktikisht e ka eliminuar vota e 14 shkurtit 2021.)

Çka po ndodhë realisht? Nën sulmet e ashpra të qeverisë Kurti, sindikatat (pra edhe SBASHK-u) po tërhiqet, po stepet. Veteranët po

poshtërohen në mënyrën më të shëmtuar. Mjekëve ua prishi sindikatën dhe ata tashmë kanë zgjedhur të ikin. Rinia urbane prishtinase nuk e votoi LV-në në Prishtinë, (e votuan Uranin e Përparimin) prandaj Kurti ka vendosur t’u hakmerret, si fillim duke ua përzënë nga qyteti “Sany Hillin”.

Për projektin e “Republikës së tretë” Albin Kurti i duhen vetëm ata që e kanë votuar: rinia e keqarsimuar dhe e paperspektivë, diaspora e mbushur dëshpërim, fshatarët

që jetojnë nga remitencat (me humor thuhet “ata që shpërblehen nga vllaznia pse e këqyrin nanën e vet), një masë e indoktrinuar e praktikuesve fetarë dhe një kontingjent pensionistësh që mbahen në shkopin e lypësit.

Për shtyrjen përpara të “Republikës së tretë”, duhet të zhvillohen shumë beteja sulmuese. LV-ja këtë punë nuk e ka problem, sepse sulmet ndaj kundërshtarëve realë e potencialë, i kryejnë pa përtesë robotët dhe militantët e saj. Robotët dhe militantët që janë

shpërblyer me poste, për dhunën psikologjike e fizike, që kanë ushtruar ndër vite.

Rreziku është që nesër të ketë provokime ndaj veteranëve dhe pastaj të thellohet fushata kundër tyre, duke i inkriminuar edhe organizatat e tyre. Uroj të mos ketë asnjë incident në protestën e veteranëve dhe që qeveria të reflektojë e të korrigjojë gabimin e saj. Uroj që Kurti ta kuptojë se nuk futet në histori, duke rrënuar themelet e shtetit. Republika nuk është kërpuhë që shfaqet e re sa herë që bie ndonjë shi.



veteranëve siç ka qenë në të kaluarën. Kurti ka thënë se qeveria ndan rreth 120 milionë euro për kategoritë e dala nga lufta dhe se kjo shifër është më e madhe sesa ajo që ndahet për sigurinë e vendit. “Unë nuk besoj që ne

dallojmë sa i përket respektit dhe mirënjohjes për veteranët e luftës së UÇK-së. Ne mund të dallojmë në bindjen tonë për numrin e tyre. Ky është një debat që zhvillohet në shoqërinë tonë, që natyrisht zhvillohet edhe në Kuvend”, ka

thënë Kurti.

Ai ka thënë se është i gatshëm të bashkëpunojë edhe me kategoritë e dala nga lufta “për të arritur te numri i vërtetë i veteranëve”. “Konsiderojmë që pjesëmarrës në luftën çlirimtare kanë qenë më

shumë se 60 mijë, por numri i veteranëve të UÇK-së është i fryrë, dhe ky është gabim edhe për historinë që do t’u mësohet fëmijëve në brezat e ardhshëm, sepse është diçka e pavërtetë”, ka deklaruar Kurti.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka kërkuar takim me shefat e grupeve parlamentare për të gjetur një kompromis. Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL të UÇK-së), Faton Klinaku, ka insistuar në ndërprerje të seancës. Pavarësisht prej propozimit zyrtar për takim të premtën në orën 09:00, Klinaku ka thënë se protestuesit do të qëndrojnë para Kuvendit. “Kërkesa jonë qysh në mëngjes ka qenë që të ndërpritet seanca dhe kemi thënë që të mos mbahen kurrfarë seancash, pasi këta e kanë shkelur ligjin. Derisa të ulemi të bisedojmë, ta kthejmë ligjin në vend ku ka qenë, ne do të qëndrojmë këtu, këta duhet ta ndërpresin seancën e sotme”, ka thënë Klinaku.

Ai nuk ka treguar nëse do të zhvillohet takimi i propozuar për të premtën.

Projektligji i miratuar parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht.

Në rast se miratohet edhe në leximin e dytë ashtu siç është, veteranët do të vazhdojnë të marrin pension në vlerë 170 euro. Veteranët kanë kërkuar që ky projektligj të mos miratohet edhe në një protestë që kanë zhvilluar para Kuvendit më 6 qershor.



IKShPK-ja bën thirrje për testim, bartje të maskave dhe vaksinim kundër Covidit

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i bartin maskat në ambiente të mbyllura dhe të vaksinohen. "Kosova këto ditë shënon numër të vogël të rasteve të reja të Covid-19 dhe, për më tepër, fatmirësisht, nuk ka as raste të vdekjeve nga kjo sëmundje. Por, në vende të ndryshme të botës ende po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia nuk ka mbaruar. IKShPK-ja është duke

vazhduar pandërprerë me testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje e shijes, rekomandohen të testohen", është thënë në thirrjen e IKShPK-së. Sipas këtij instituti, me qëllim të përfortimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe

formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen që të vaksinohen, me dozën e parë ata që ende s'janë vaksinuar, kurse të tjerët me dozën e dytë dhe dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19. "MSh-ja dhe IKShPK-ja rekomandojnë qytetarët që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19", është bërë me dije në njoftimin e IKShPK-së.



AKB-ja dhe Oda e Zejtarëve të Prizrenit nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Aleanca Kosovare e Bizneseve dhe Oda e Zejtarëve të Prizrenit kanë nënshkruar të enjten memorandum bashkëpunimi për të mirën e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar në të mirë të zejtarëve.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se bashkëpunimi i përbashkët do të shkojë në drejtim të zhvillimit ekonomik në nivel qendror dhe lokal, duke mos e përjashtuar edhe sektorin e zejtarëve të Kosovës të cilët janë një nga hallkat e trashëgimisë

ekonomike. "Zejtarët i vlerësojmë si të rëndësishëm së veçantë për arsye se zejtarët, përpos që e kanë mbajtur aktive ekonominë familjare dhe individuale, janë kontributdhënës në ruajtjen e traditës përmes zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Tashmë është koha që tani të zënë një vend të rëndësishëm në ekonominë kombëtare", ka thënë Shahini. Kryetari i Odës Zejtarëve të Prizrenit, Afrim Tejeci, ka thënë se janë duke fuqizuar misionin e zejtarëve në nivel lokal dhe atë kombëtar. Ai ka thënë se

marrëveshja e nënshkruar do të mbështetë çdo iniciativë të zejtarëve të Prizrenit dhe me gjerë për ta rritur zhvillimin dhe prodhimin e produkteve të ndryshme nga zejtaria për tregun e Kosovës. "Prandaj nga sot rrugëtimi ynë dhe iniciativat tona do të mbështeten nga një partner me traditë 20-vjeçare siç është AKB-ja", ka thënë Tejeci.

Të dyja palët u pajtuan që së shpejti të marrin edhe iniciativat të tjera të përbashkëta për fuqizimin e zejtarëve në nivel kombëtar.

Hapet edicioni i dytë i 'Bienales Ndërkombëtare të Vizatimit 2022'



Prishtinë, 16 qershor (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar se artistë nga trembëdhjetë shtete të rajonit dhe Evropës kanë paraqitur veprat e tyre në hapjen e edicionit të dytë të "Bienales Ndërkombëtare të Vizatimit 2022" në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Sipas MKRS-së, e veçanta e këtij edicioni për këtë vit është ndërthurja e teknikave më të reja të vizatimit që aplikohen në botë. Në ceremoninë e hapjes janë

shpërblyer tre artistët më të mirë. Çmimin kryesor të Bienales "Grand Prix - Gjelo Gjokaj" për artistin Agim Salihu e ka dhënë ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, i cili ka thënë se Bienala Ndërkombëtare e Vizatimit 2022 është një traditë e cila begaton jetën kulturore dhe artistike në vendin tonë.

Po ashtu, janë dhënë edhe dy çmime të tjera për Ake Bregqivist nga Suedia dhe Nehat Beqiri nga Maqedonia e Veriut.

Pjesë e kësaj ngjarjeje ishin edhe përfaqësues nga Galeria Kombëtare e Kosovës, Asociacioni i Artistëve Vizualë të Kosovës dhe përfaqësues të Ambasadës së ShBA-së dhe të Maqedonisë së Veriut.

Ekspozita dhe katalogu i edicionit të dytë të "Bienales Ndërkombëtare të Vizatimit 2022" janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa ekspozita do të jetë e hapur për publikun deri më 12 korrik.



Asfaltohet rruga "1 Tetori" në kryeqytet

Prishtinë, 16 qershor (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar të enjten për asfaltimin e rrugës "1 Tetori". Ai ka thënë se kjo

rrugë, duke qenë ndër ato më të qarkullueshmet dhe që mundëson lidhjen me disa lagje, do ta lehtësojë qasjen e qytetarëve nëpër kryeqytet.

Rama akuzon qeverinë Kurti për dështimin e 'Sunny Hill'-it

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, e ka akuzuar Qeverinë e Kosovës për zhvendosjen e Festivalit "Sunny Hill" në Tiranë. Sipas Ramës, zhvendosja ka ndodhur kryekëput nga zvarritjet e qeverisë. Ai ka bërë me dije se festivali i zhvendosur në Tiranë "do t'i shkaktojë dëm kryeqytetit në kulturë, turizëm, në zhvillimin ekonomik dhe në imazhin e përgjithshëm". Rama në një konferencë për

medie ka thënë se "Sunny Hill" ka kaluar në Tiranë për shkak të zvarritjeve të Qeverisë së Kosovës. "Sunny Hill" nuk do të mbahet sivjet në Prishtinë. Ky është në lajm dëshpërues për kryeqytetin dhe për Kosovën. 'Sunny Hill' i takon Kosovës, i takon Prishtinës, u takon të rinjve dhe të rejave tona që me padurim e kanë pritur edicionin e sivjetmë. Arsye pse ky festival mbahet në Tiranë është se institucionet qendrore kanë tentuar vazhdimisht të hyjnë në kompetencat e Kuvendit

Komunal. Ky festival është zhvendosur në Tiranë për shkak të zvarritjeve të qeverisë dhe ndërhyrjeve në kompetencat e kryetarit të komunës. Për fat të keq, çështjet e tilla janë bërë për poenë politike, që të tentohet që vendimin ta rikthejnë në Kuvend kundër vullnetit të shumicës së asamblesë e cila përfaqëson vullnetin e sovranit në Prishtinë", ka thënë Rama. Ai ka thënë se është paraparë që profiti i kryeqytetit nga ky festival sivjet të ishte rreth 12 deri në 15 milionë euro.



Raportime të rrejshme për bomba në disa shkolla të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Policia e Kosovës të enjten në orët e hershme të mëngjesit nga personeli i disa shkollave ka pranuar informacione për kërcënime me mjete shpërthyes (bomba) në disa objekte shkollore, të ndodhura kryesisht në zona të banuara me popullatë serbe. "Bazuar në informacionet e deritanishme, këto kërcënime janë bërë në rajone të ndryshme në disa objekte shkollore (deri më tani në rreth 30 lokacione), e të cilat kërcënime janë pranuar përmes formës elektronike dhe linjave telefonike. Referuar informacioneve të pranuar, Policia e Kosovës menjëherë ka ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme policore në funksion të trajtimit dhe hetimit të këtyre rasteve, duke angazhuar

njësitet relevante policore, përfshirë ato për trajtimin e materieve shpërthyes dhe njësitin me qenë (K-9)", ka njoftuar Policia e Kosovës. Policia e Kosovës, po ashtu, ka njoftuar se ka ndërmarrë veprime konkrete duke evakuuar personat në perimetrat e sigurisë përderisa ta vazhdojë angazhimin e saj për ruajtjen e rendit kushtetues, garantimin e sigurisë në nivel vendi si dhe ofrimin e sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve pa dallime. "Deri në këtë fazë Policia e Kosovës ka arritur t'i trajtojë dhe verifikojë disa nga objektet shkollore të cilat kanë rezultuar të jenë kërcënime të rrejshme, andaj i ftojme qytetarët që të mos krijojnë ndonjë panik, pasi Policia e Kosovës është e pranishme dhe e angazhuar në trajtimin, hetimin dhe ofrimin e sigurisë në të gjitha lokacionet në nivel vendi", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Osmani merr pjesë në Forumin e Prespës në Maqedoninë e Veriut



PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Me ftesë të presidentit të Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka udhëtuar për në Maqedoninë e Veriut për të marrë pjesë në Forumin e Prespës për dialog me temë: "Formësimi i të ardhmes së Ballkanit Perëndimor në arkitekturën bashkëkohore evropiane të sigurisë", i cili i zhvillon punimet nga data 16 deri 18 qershor në Ohër. Presidentja Osmani do t'i drejtohet panelit përgjatë sesionit kryesor të

hapjes zyrtare, me krerë të tjerë shtetesh, me temën: "Çfarë pas luftës në Ukrainë?", ku do të diskutohet mbi realitetin e ri gjeopolitik të krijuar nga lufta në Ukrainë, forcimin e unitetit transatlantik si dhe përgjigjen e përbashkët kundër agresionit rus. Forumi i Prespës për Dialog do të jetë nikoqir i krerëve të shteteve të rajonit, përfaqësuesve nga BE-ja, ShBA-ja, e personaliteteve të shquara nga fusha e politikës, sigurisë, ekonomisë, nga komuniteti akademik dhe ai i

biznesit. Gjatë Forunit, presidentja Osmani do të ketë takim bilateral me homologun e saj Stevo Pendarovski si dhe me zyrtarë të lartë të shteteve të tjera pjesëmarrëse. Krahas sesionit të hapjes zyrtare dhe takimeve bilaterale, presidentja Osmani do të jetë ndër folëset kryesore edhe në panelin e diskutimit "Samiti i Demokracisë: Rëndësia e grave në qeverisje", ku do të diskutojë për avancimin e agjendës së grave, sigurisë dhe paqes.

17 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 16 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 204 testeve, 17 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe 10 qytetarë, derisa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 225 269. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 74. Në 24 orët e fundit janë dhënë 60 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 830 068 doza të vaksinës. Deri më sot 823 509 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Po ashtu, deri më sot janë dhënë 103 047 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Supremja vendos në favor të ZRrE-së, mbesin në fuqi faturat e shtrenjta



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 16 qershor - Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka aprovuar kërkesën e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe ka marrë vendim që t'i ndryshojë vendimet e Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Themelore, duke e konsideruar kërkesën e PDK-së për shtyrje të vendimit të ekzekutimit të vendimit për tarifën e reja të energjisë të pabazuar. "Kolegji i Gjykatës Supreme në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit - propozuesit - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kundër të paditurit - kundër propozuesit Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE), me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit, nr. prot. 077/22 të datës 16.02.2022 dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga i padituri ZRrE, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, e ka aprovuar si të bazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga e

KESCO do të aplikojë te konsumatorët tarifën paraprake deri në vendimin e ZRrE-së

KESCO ka njoftuar të enjten se në ditët në vijim do të fillojë procesi i leximit të shpenzimeve dhe dërgimi i faturave te konsumatorët. Për ta qartësuar situatën e krijuar pas vendimit të Gjykatës së Apelit, përkatësisht vendimit të Rregullatorit të datës 20 maj për pezullimin e tarifave të datës 8 shkurt 2022, KESCO ka kërkuar sqarime shtesë nga ZRrE-ja lidhur me interpretimin e vendimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ZRrE-së për tarifën e energjisë elektrike të marrë më 8 shkurt 2022, si dhe ka kërkuar udhëzime se cilat tarifa janë në fuqi, përkatësisht si të vazhdohet procesi i

leximit të njehsorëve dhe faturimit i konsumatorëve. "Për ta shmangur këtë situatë që ndërlihet drejtpërdrejt me sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend, dhe deri në vendimin e ardhshëm të ZRrE-së si institucion përgjegjës për aprovimin e tarifave fundore, KESCO i ka propozuar ZRrE-së që të aplikohet vendimi paraprak i ZRrE-së, përkatësisht i datës 27 tetor për tarifën e energjisë elektrike që ishin të aplikueshme deri më 8 shkurt 2022. Duke mos pranuar ende përgjigje dhe udhëzimet e nevojshme nga Rregullatori, në anën tjetër duke qenë në prag të leximit të shpenzimeve

dhe faturimit, KESCO, e gjendur para një situatë jo të lehtë, deri në vendimin e ardhshëm të ZRrE-së ka vendosur që t'i aplikojë tarifën paraprake, pra tarifën që ishin në fuqi para datës 8 shkurt", është thënë në njoftimin e KESCO-s, duke shpresuar se për këtë situatë do ta gjendet një zgjidhje më e mirë. "Ne i sigurojmë konsumatorët se nuk do të dëmtohen asses nga ky proces dhe varësisht nga vendimi final që do të pranohet nga ZRrE-ja, si institucion përgjegjës, KESCO do t'i zbatojë të gjitha përshtatjet e nevojshme", është theksuar në njoftimin e KESCO-s.

paditura Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE), kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit. Kolegji i Gjykatës Supreme e ka ndryshuar aktvendimin e Gjykatës së

Apelit dhe aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe e ka refuzuar të pabazuar kërkesën - propozimin e paditësit Partia Demokratike e Kosovës për

shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji", thuhet në vendimin e Gjykatës Supreme. Më tej theksohet se Gjykata

Supreme përmes aktgjykimit ARJ nr. 45/2022 vlerëson se duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes nuk mund të aprovohet si i drejtë dhe ligjor qëndrimi juridik i gjykatës së Apelit dhe i gjykatës së shkallës së parë si në aktvendimet e kontestuara me kërkesë. "Në rastin konkret Gjykata e Apelit është dashur në mënyrë kumulative, ashtu si parashihet në nenin 22, par. 2 të LKA-së, t'i vlerësojë drejt të gjitha rrethanat dhe faktet sipas specifikave të çështjes së vendosur si në vendimin e organit të paditur të ZRrE, prandaj gjykata e shkallës së parë me rastin e lëshimit të masës së përkohshme kontestuese, gabimisht ka zbatuar këtë dispozitë ligjore, sikur edhe gjykata e shkallës së dytë kur ka aprovuar një qëndrim të tillë të gjykatës së shkallës së parë sepse, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, arsytimi i aktvendimit të kontestuar me kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, por edhe ai i shkallës së parë, është jobindës dhe jokonkret lidhur me faktet vendimtare në të cilat këto vendime bazohen. Faktet dhe konkludimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përgjithshme dhe, si të tilla, të paargumentuara për atë se cili është dëmi konkret dhe si është i matshëm ky dëm që i shkaktohet paditësit, i cili vështirë do të riparohej para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit të kontestuar në procedurë të rregullt gjyqësore, gjersa shtyrja nuk do të ishte në dëm të palës kundërshtare apo palës së interesuar dhe shtyrja nuk do të ishte në kundërshtim me interesin publik", është thënë në këtë vendim. Sipas këtij vendimi të Gjykatës Supreme, rezultoni se arsytimi i aktvendimit kontestues të Gjykatës së Apelit nuk përmban arsye ligjore dhe bindëse sipas provave në shkresë të lëndës për kushtet ligjore që kërkohen sipas nenit 22 të LKA për lëshimin e masës së përkohshme, duke mos u bërë i besueshëm dëmi i riparueshëm që do ta justifikonte masën e përkohshme në këtë fazë dhe duke mos paragjykuar përfundimin e procedurës së vendosjes sipas padisë në mënyrë meritore lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ.

Në Rahovec bëhet shpërndarja e pajisjeve për sektorin e bletarisë

RAHOVEC, 16 QERSHOR (ER) - Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë, ka bërë

shpërndarjen e pajisjeve për bletari, ku gjithsej 38 bletarë të enjten i kanë pranuar pajisjet (centrifuga për mjaltë

dhe shkrirëse të dyllit me avull). Komuna e Rahovecit ka njoftuar se në ditët në vazhdim do të vazhdohet

shpërndarja e pajisjeve të tjera varësisht prej furnizimeve nga operatorët ekonomikë.



Historia e spiunit që siguroi suksesin e zbarkimit në Normandi



Johann JEBSEN

Nga: Davide BARTOCCINI

Ndonjëherë guximi, ashtu si mençuria, gjenden në vendet më të papritura të mundshme. E tillë është edhe historia e Johnny Jebsenit, që njihet me nofkën "Artisti". Spiuni që duroi çdo lloj torture, për të mos rrëfyer identitetin e shokëve të vet, dhe për të mbajtur të sigurt sekretet e manovrave që ishin thelbësore për suksesin e Operacionit Overlord: zbarkimi i trupave aleate në Normandi.

I lindur në Hamburg të Gjermanisë në vitin 1917, dhe me origjinë daneze, Johann-Nielsen Jebsen ishte trashëgimtari i një kompanie transportuese shumë fitimprurëse, "Jebsen & Jebsen", selia e së cilës ishte zhvendosur në Gjermani. Një lëvizje që i dha atij dhe familjes komoditetin e nënshtrimit të dyfishtë.

Prindërit, të cilët vdiqën qëkur ai ishte vetëm fëmijë, lanë një pasardhës me një mendje të shkëlqyer, me një sens të madh humori, dhe sjellje shembullore. Duke u dashuruar me Anglinë dhe fshatin ku kishte kaluar shumë kohë gjatë fëmijërisë, i riu Jebsen adoptoi mënyrat angleze të jetesës.

Kjo e ndihmoi shumë në misionin e rrezikshëm që mori përsipër gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në vitet 1930 vazhonte studimet në Universitetin e Freiburgut, duke bërë jetën e një plejboji. Aty u

njoh me atë që do të bëhej miku i tij më i mirë, Dushko Popov, agentin e dyfishtë që frymëzoi Jan Flemingun të krijonte Xhejms Bondin e tij.

Kur shpërtheu lufta, Jebseni ishte oficer i shërbimeve sekrete naziste, me shumë miq me ndikim. Përfshiu në punën e vet miq të vjetër të universitetit, duke i mbajtur ata "larg" nga fronti dhe duke i rekrutuar nga shërbimi sekret ushtarak gjerman, Abwehr, i drejtuar nga admiral Canaris.

"Besnikëria" e tij ndaj regjimit nazist si spiun, ishte e lidhur ngushtë me gatishmërinë e tij për t'i shpëtuar shërbimit të detyrueshëm ushtarak që duhej të bënte në ushtri. Prandaj, Jebseni u lejua të vazhdonte aktivitetet e tij normale si biznesmen, që përbënte një mbulim të përsosur për rolin e tij si spiun.

Kërkonte informacione dhe informatorë për Berlinin, i cili e furnizonte atë me shuma të mëdha parash për udhëtimet që bënte jashtë vendit. Por, nuk u desh shumë kohë që ai të bëhej një agent i "dyfishtë". Kështu u përfshi në një lojë shumë të rrezikshme, ku objekt i mashtrimeve të tij nuk do të ishin më britanikët, por kundërspiunazhi nazist, SD, dhe Gestapo.

Gjatë luftës, Jebseni, që rekrutoi mikun e tij të vjetër Popov si spiun në shërbim të Adolf Hitlerit, u rekrutua vetë për t'u bërë pjesë e të ashtuquajturit

"Sistemi XX", një rrjet kundërzbulimi i krijuar nga MI5-ja britanike. Synonte t'i shfrytëzonte spiunët që nazistët i kishin depërtuar në Angli – të vërtetë apo të rremë – përmes shpërndarjes së synuar të informacionit të falsifikuar.

Operacioni synonte ta ngatërronte armikun dhe ta largonte atë nga objektivat e vërteta të aleatëve. Abwehr-i dhe SD-ja u përpoqën të depërtonin përmes shumëve spiunëve në Angli. Shumë nga agentët vepronin në vende neutrale si Spanja, Portugalia dhe Irlanda. Kjo ishte mënyra më e thjeshtë, dhe u jepte mundësi individëve si Jebsen dhe Popov të kalonin javë të tëra duke pushuar midis hoteleve dhe kazinove, duke pritur udhëzime dhe duke ndërmarrë veprime për të mbledhur informacionin e kërkuar.

Megjithatë, kundërzbulimi britanik arriti të rekrutonte gati të gjithë agentët e dërguar nga Gjermania. Në këtë mënyrë ai zhduku të gjitha llojet e informacioneve reale nga prapavija e forcave aleate, dhe i furnizoi shërbimet sekrete gjermane me të dhëna false, enkas të krijuara.

Në fund të luftës u zbulua se të gjithë agentët e dërguar nga nazistët në Britani, ishin dorëzuar dhe kishin pranuar të bënin lojën e dyfishtë, ishin arrestuar ose nuk kishin ekzistuar kurrë.

Që nga viti 1943 e tutje, Johnny

Jebsen ishte agent i dyfishtë në shërbim të kauzës së aleatëve, ndërsa vazhdonte të pretendonte se ishte një besnik i madh ndaj gjermanëve. Jebsen ishte në dijeni të disa prej sekreteve më të rëndësishme të aleatëve: planet reale të zbarkimit në Normandi, dhe mbi një operacioni të madh që kishte synime çorientuese për t'i bindur gjermanët se zbarkimet do të ndodhnin në sektorë të tjerë të plazhit të Normandisë. Por, loja e tij nisi të ngjallte dyshime. Miku i tij, Popov, që në fakt arriti të shpëtonte, e këshilloi të shkonte në Angli. Por, për Jebsenin, ishte tepër vonë. Ndoshta ai nuk i mori gjërat shumë seriozisht. Kështu, më 29 prill 1944, vetëm katër javë përpara datës së përcaktuar fillimisht për zbarkimin në Normandi, Jebseni u kap në Lisbonë pas një përplasje të shkurtër me armë. U fut në një makinë dhe u dërgua në Francën ende të pushtuar. Arrestimi u krye nga Aloys Schreiber, kreu i kundërzbulimit gjerman në Lisbonë, që e kishte kontaktuar me pretekstin e dhënies së shpërblimit.

Torturuesit e SD-së nisën ta torturojnë për të nxjerrë informacione prej tij. Ata donin emrat e spiunëve që bënin lojë të dyfishtë, identitetet e rekrutuesve, sekretet e aleatëve, dhe të gjitha planet e tyre. Por "Artisti" nuk e lejoi veten të pushtohej nga frika dhe dhimbja. Nuk zbuloi asnjë nga


sekretet që dëshironin nazistët. Më pas u dërgua në selinë e Gestapos në Berlin, ku vazhduan torturat dhe marrja në pyetje. Por, Jebsen nuk foli. Në korrikun e vitit 1944, ndërsa aleatët po marshonin tashmë drejt Parisit, Jebsenin u transferua në kampin e përqendrimit Sachsenhausen. Sipas raportimeve, mbërriti atje me brinjë të thyera dhe shenja të qarta të traumës dhe kequshqyerjes. Por, kjo nuk e pengoi të thurte plane për arratisjen. Arriti të dërgojë mesazhe në Angli, por në Zyrën e Luftës askush nuk e dinte emrin e vërtetë të agentit në nofkën "Artisti" ndaj çdo kërkesë e tij u shpërfill.

Në shkurtin e vitit 1945, Gestapo vendosi ta transferonte në një kamp të ri. Nga ai moment fati i tij mbeti një mister. Trupi i tij nuk u gjet kurrë. Ndoshta përfundoi si shumë të tjerë në ndonjë varr masiv. Më 17 shkurt 1950 u shpall zyrtarisht i vdekur.

Mbetet ende i habitshëm fakti që Jebsen dinte, dhe për këtë arsye ai mund të kishte rrëfyer gjithçka. Duke tradhtuar aleatët dhe mikun e tij Popov, mund të shkëmbente jetën e tij me sekretin e pushtimit të Evropës. Por, nuk i tha asnjë fjalë Gestapos. Kishte një grua dhe një fëmijë që e prisnin në shtëpi. Por, as në Francë, as në Berlin, dhe as në kampin e përqendrimit Sachsenhausen nuk u tregoi asgjë nazistëve. /Marrë me shkurtime nga Il Giornale/Në shqip nga: Bota.all

EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Marmarinos publikon listën e gjerë të basketbollistëve



PRISHTINË, 15 QERSHOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës A, Christos Marmarinos, në konsultim me shtabin teknik, ka shpallur listën e gjerë të basketbollistëve për ndeshjen e qershorit ndaj Danimarkës në kuadër të parakualifikimeve për FIBA Eurobasket 2025. Në listën e gjerë janë ftuar 14 basketbollistë, të cilët do të mbikëqyren dhe më pas do të shpallet lista përfundimtare. Stërvitjen e parë basketbollistët e zhvillojnë sot (e premte) nga ora 18:00 në palestrën sportive të Kolegjit "ISP" në Marigona Residence. Sa iu përket të ftuarve,

për herë të parë të Kosova A janë ftuar basketbollistët Etnik Peci dhe Ardit Pepaj. "Dardanët" e zhvillojnë ndeshjen me Danimarkën më 30 qershor. Kosova është në grup me Danimarkën dhe Norvegjinë ku renditet e dyta me tri pikë të grumbulluara, aq sa ka edhe Norvegjia në vendin e parë. Numri i kombëtareve pjesëmarrëse në parakualifikime të FIBA Eurobasket 2025 është 10, ku një grup përbëhet nga katër kombëtare, kurse dy grupe të tjera me nga 3 kombëtare. Katër skuadra, tri fituesit e grupeve, dhe

një kombëtare e cila është e renditur në pozitën e dytë, më së miri do të kualifikohen për raundin e dytë parakualifikues. Raundi i dytë do të mbahet midis gushtit 2022, nëntorit 2022 dhe shkurtit 2023.

Lista e gjerë e basketbollistëve:

Valon Bunjaku, Amin Hot, Etnik Peci, Dardan Berisha, Mikaile Tmusiq, Altin Morina, Meriton Ismaili, Ardit Pepaj, Drilon Hajrizi, Muhamedali Janjeva, Rron Ukaj, Samir Zekiqi, Gëzim Morina, Fisnik Rugova.

SHKURT

Gazetari gjerman: Rashica nuk kalon te Schalke 04

Pas rënies nga Premierliga të skuadrës së Norwichit, Milot Rashica me gjasë do të ndryshojë skuadër. Ndonëse ai po kërkohet nga Schalke 04, gazetari gjerman ka zbuluar se Rashica nuk do të transferohet atje. Dirk Schlarmann ka shkruar se Rashica nuk do të nënshkruajë për skuadrën e Schalkes këtë verë. "Po, Milot Rashica do të donte të rikthehej në Bundesligë. Jo, nga sot ai nuk do të shkojë në Schalke 04. Financiarisht, një marrëveshje e tillë është përtej mundësive të Schalkes", ka njoftuar ai në "Twitter". Rashica ka luajtur në Gjermani edhe më parë kur ishte pjesë e Werder Bremenit.

Broja, ndër më të kërkuarit në Evropë

Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, është një nga lojtarët më të kërkuar në Evropë. Paraqitjet e mira me fanellën e Southamptonit, por edhe me kombëtaren kuqezi, kanë bërë që shumë klube të vihen pas tij. E fundit që ka shprehur haptazi dëshirë për Brojën është skuadra e Atalantës. Chelsea, e cila e ka kartonin e lojtarit, kërkon 30 milionë euro.

Fati i Strakoshës, në duart e Kepas

Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Thomas Strakosha, ka vendosur mos ta rinovojë kontratën me Lazio. Portieri shqiptar mund ta vijojë karrierën në një klub të madh si Chelsea. Fulhami deri më tani ka këmbëngulur për portierin shqiptar, por interesimi i "Bluve" të Londrës ka ndryshuar të gjitha planet, pasi Chelsea është në kërkim të një zëvendësuesi për Mendyn. Chelsea do ta transferojë Strakoshën vetëm në rast se do të largohet Kepa. Një gjë e tillë ka shanse që të ndodhë për shkak se portieri nuk është i lumtur me aktivizimin në Londër.

Fury mund ta mbajë titullin 12 muaj pa pasur nevojë ta mbrojë

Tyson Fury vazhdon të jetë i paqartë lidhur me të ardhmen e tij. Kampioni i WBC në peshat e rënda të boksit, Fury, kishte paralajmëruar pensionimin pas fitores ndaj Dillian Whyte. Megjithatë, së fundmi ai ka thënë se mund të kthehet në ring nëse oferta e duhur i vjen në tavolinë. Me gjithë kohën që po e merr për të vendosur për të ardhmen e tij, Fury nuk po rrezikon shumë. Tyson Fury ligjërisht ka të drejtë ta mbajë titullin e kampionit të WBC për 12 muaj. Në këtë periudhë ai nuk është i obliguar të përballet me ndonjë kundërshtar për ta ruajtur titullin e tij. Gjasat janë të mëdha që boksieri të kthehet në ring për duelin me Oleksandr Usyk apo Anthony Joshua, varësisht fituesit.

Kosova zhvillon miqësore me Malin e Zi

PRISHTINË, 16 QERSHOR - Përfaqësuesja U-20 e meshkujve sot (e premte) zhvillon miqësore me Përfaqësuesen e Malit të Zi U-

18. Ndeshja zhvillohet në Pallatin e Rinisë nga ora 19:30. Kjo ndeshje zhvillohet në kuadër të përgatitjeve para FIBA Kampionatit Evropian

U20, Divizioni B, i cili do të zhvillohet në Tbilisi të Gjeorgjisë. Në listën e përzgjedhësit të Kosova U20, Dritero Sefaja, deri më tani

janë 16 lojtarë, ku në listën e ngushtë do të jenë vetëm 12 lojtarë. Ndeshja është e hapur për publikun, ndërsa hyrja do të jetë falas.



MotoGP gati t'i heqë Italisë një garë

ROMË, 16 QERSHOR - Botërori i MotoGP rrezikon të humbasë një nga pistat italiane, atë të Mugello apo Misano në të ardhmen. Faji për këtë është i Valentino Rossit që, pas largimit nga MotoGP, ka bërë që interesimi për këtë sport

në "gadishull" të bjerë ndjeshëm në vetëm fare pak muaj. Këtë gjë e konfirmoi gara e zhvilluar në Mugello një muaj më parë, ku numri i spektatorëve ra ndjeshëm krahasuar me një vit më parë, kur Rossi garonte ende. Për këtë arsye,

Dorna, kompania që menaxhon garat e MotoGP, ka deklaruar se mund të heqë një nga dy garat që zhvillohen aktualisht në Itali. Carmine Ezpeleta, shefi i Dornas, ka deklaruar: "Gara e Mugellos këtë vit ka shkuar më keq se garat

e tjera të këtij sezoni për shumë arsye. Një është mungesa e Rossit dhe fansave të tij. Tjetër arsye është zhvillimi i asaj gare në një ditë me atë të Montekarlo apo promovimi jo i mirë që iu bë kësaj gare".



KOK-u fitoi turneun e Ditës Olimpikë 2022

Prishtinë, 16 qershor - Komiteti Olimpik i Kosovës ka fituar turneun e futbollit të madh, të organizuar për nder të Ditës Olimpikë 2022. KOK-u në finale mundi Veteranët e Futbollit, 5-4 pas penalltive, pasi koha e rregullt u mbyll pa fitues (0-0). Pjesëmarrëse në turneun që u zhvillua në stadiumin "Ibrahim Gashi" në Taukbahe të Prishtinës ishin edhe ekipet e Ministrisë për Kulturë, Rini e

Sport (MKRS), komuna e Prishtinës, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia e Kosovës (PK) dhe gazetarët sportivë. Të pranishëm në stadium ishin edhe zëvendësministrja e MKRS-ja, Daulina Osmani, kryetari i FFK-së, Agim Ademi, legjenda e sportit tonë, Ferit Zekolli, i cili ndau edhe medaljet, si dhe personalitete të tjera. KOK-u deri në finale mundi MKRS-në dhe komunën e Prishtinës, të dyja me

rezultat 2-0. Çmimi i lojtarit më të mirë i takoi Shpëtim Gërvallës. Me medalje u nderua edhe finalisti - Veteranët e Kosovës, të cilët paraprakisht kishin fituar ndaj Policisë së Kosovës dhe FSK-së. KOK-u ka falënderuar të gjitha ekipet pjesëmarrëse, gjyqtarët e FFK-së, si dhe mikpritësit e stadiumit për kontributin e dhënë gjatë këtij aktiviteti që u organizua në kuadër të Javës Olimpikë 2022.



Benzema: Pas pensionimit dua të bëhem trajner

MADRID, 16 QERSHOR - Tërheqja është ende shumë larg, por deri më sot Karim Benzema duket se ka ide mjaft të qarta se çfarë do të donte të bënte sapo t'i varë këpucët në gozhdë. Sulmuesi i kombëtares franceze dhe Real Madridit, i intervistuar nga "Onze Mondial", shpjegoi se cila është dëshira e tij pas pak vitesh, ndoshta duke ndjekur gjurmët e personazheve si Zidane që, pasi vari këpucët, bëri gjëra të mëdha si ndihmës dhe më pas si trajner i parë. "Nëse e kam menduar tashmë se çfarë do të bëj pas daljes në pension dhe nëse do të jem trajner? Vërtet nuk e di. Nuk e di nëse do të jem trajner, por ndoshta mund të jetë", ka thënë Benzema. "Sidoqoftë, unë e dua shumë futbollin, kështu që ajo që do të bëj pasi të tërhiqem, sigurisht se do të jetë diçka afër të qenit trajner. Në



çdo rast do të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja", ka shtuar Benzema, i cili këtë sezon e udhëhoqi Real Madridin me një

lumë golash drejt fitores në La Liga dhe Ligën e Kampionëve dhe aktualisht është kandidati kryesor për "Topin e Artë 2022".

SHKURT

Revolucioni i Juventusit

Juventusit ka fronte të ndryshme të hapura në këtë merkato verore. Ai që duket më i afër është Paul Pogba, i cili do të rikthehet te Juventusit pas largimit nga Manchester Unitedi. Nga ana e tij, Angel Di María (lojtar i lirë) do t'i jepte përparësi afrimit te Barcelona. Po kështu, Juventusit po punon për blerjen e Luis Suarezit (ish-lojtarin e Barçës dhe Atletico Madridit me kosto zero. Dhe mos e humbisni. Edhe emri i Kalidou Koulibaly është në planet e torinezëve teksa ky i fundit ende nuk ka rinovuar.

Ibra edhe një vit qëndron te Milani

Kontrata aktuale e Zlatan Ibrahimoviçit me Milanin përfundon më 30 qershor, por ai nuk do të largohet nga skuadra kuqezi. Mediet italiane raportojnë se Ibra dhe Milani kanë gjetur pajtim, ndërsa firma mbi kontratë pritet të hedhet në javët në vijim. Sulmuesi do të firmosë një kontratë njëvjeçare deri në përfundim të 2023-s, ndërsa do të përfitojë rreth 2 milionë euro në sezon plus bonuse të ndryshme që do të jenë të lidhura me paraqitjet e tij individuale, golat dhe praninë e tij në fushë, sigurisht edhe arritjet si skuadër.

Chelsea kërkon 15 milionë nga Interi për Lukakun

Negociatat në mes të Chelseas dhe Interit po vazhdojnë. Sulmuesi belg Romelu Lukaku dëshiron të bëjë një tjetër lëvizje këtë verë për t'u kthyer te skuadra e Interit. Lojtari nuk kaloi mirë në transferimin e tij nga Interi te Chelsea dhe tani dëshiron të kthehet në Itali. Por, Interi duhet të paguajë 15 milionë euro për ta marrë belgun në formë huazimi. Megjithatë, Di Marzio insiston se me një ofertë të përafërt, që shkon deri në 10 milionë euro, mund të arrihet marrëveshje. Interi dhe Chelsea kanë pasur takime pozitive dhe tashmë duket shumë e gjashme mundësia që belgu të kthehet në Serinë A.

Lewandowski: Nuk mund të them asgjë për të ardhmen time

Sulmuesi Robert Lewandowski kishte premtuar se do të fliste për të ardhmen e tij pasi të kishte përfunduar së luajturi për Poloninë në Ligën e Kombeve në qershor. Por pavarësisht se luajti ndeshjen e tij të fundit ndërkombëtare të sezonit të martën, sulmuesi nuk ishte në gjendje të zbulonte më shumë për destinacionin e tij të ardhshëm. "Kam premtuar se pas ndeshjes kundër Belgjikës do të them më shumë për të ardhmen time. Ju lutem kuptoni se nuk mund të them asgjë të re", ka thënë Lewandowski.

Nëse Mick Schumacher nuk ndryshon, vendin e tij e zë piloti italian

Ky mund të jetë sezoni i fundit i Mick Schumacherit me makinën Haas në Formula 1. Drejtuesit e makinës amerikane kanë mbetur deri më tani të zhgënjyer nga paraqitjet e pilotit të ri gjerman, djali i shtatë herë kampionit të botës Michael Schumacher. Të Haas po mendojnë që tani për vitin 2023 dhe në rast se Mick nuk ndryshon paraqitje në pistë, atëherë do të largohet. Ndërkohë që, i sigurt duket danezi Kevin Magnussen, të cilit Haas synon t'i afrojë një pilot me më shumë përvojë. Sipas kontratës, Haas duhet të ketë një pilot të Akademisë Ferrari, vend që për momentin e mban Mick. Gjithsesi, vitin tjetër këtë vend mund ta zë një pilot italian, Antonio Giovinazzi, që deri vjet ka garuar me Alfa Romeo. Një tjetër emër që pritet ta zëvendësojë Mick Schumacherin është Robert Shwartzman apo vëllai i Charles Leclerc, Arthur Leclerc. Të dy këta pilotë të rinj janë pjesë e Akademisë Ferrari. Gjithsesi, gjithçka do të varet nga paraqitja e pilotit të ri gjerman në pjesën e dytë të sezonit.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
(Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

